

Vendim nr. 142 datë 24.06.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marsida Xhaferllari, Anëtare
Marjana Semini, Anëtare

në datën 24.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (R) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: RIZA RAZA, përfaqësuar nga avokat Roland Islami, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 86-2016-735 (3469), datë 26.10.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2023-5218, datë 19.12.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 27, 28, 29 dhe 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Holta Zaçaj, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Riza Raza ka qenë i punësuar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore (DRT), Dibër prej datës 16.06.2006, së fundmi në detyrën e specialistit në Sektorin e Shërbimit të Tatimpaguesit.

2. Me shkresën nr. 2163 prot., datë 29.01.2015 të Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), me lëndë “Konstatimi i shkeljes disiplinore”, i është propozuar drejtorit të përgjithshëm të Tatimeve fillimi i ecurisë disiplinore për disa punonjës, përfshirë kërkuesin, pasi sipas informacionit të Departamentit të Procedurave dhe Teknologjisë, nga verifikimi i kryer në serverin e institucionit, deklarimi *online* për disa subjekte tatimpagues është kryer nga kompjuteri i punës i kërkuesit dhe gjatë orarit zyrtar.

3. Me shkresën nr. 2163/1 prot. datë 03.02.2015 të drejtorit të përgjithshëm të Tatimeve kërkuesi është njoftuar për fillimin e procedimit disiplinor, si dhe për të drejtën për të paraqitur me shkrim sqarimet dhe provat rreth shkeljes së pretenduar, për t`u paraqitur në mbledhjen e komisionit disiplinor për t`u dëgjuar vetë ose me përfaqësues, si dhe për të paraqitur dëshmitarë. Kërkuesi ka paraqitur observacion, i protokolluar me nr. 2163/4 prot., datë 09.02.2015, ku ka sqaruar se në datën 06.01.2015 është paraqitur një numër i madh tatimpaguesish të biznesit të vogël për të kërkuar informacion dhe për të mundësuar pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, por duke qenë se sistemi i ri nuk ishte ende funksional dhe deklaratimet në sistemin e vjetër nuk migroheshin në sistemin e ri, ai ka kryer veprimet për ta *online*, pa asnjë shpërblim, si pasojë e insistimit të subjekteve tatimpaguese dhe dëshirës për t`u ardhur atyre në ndihmë, si dhe për të kontribuar në realizimin e të ardhurave, që është qëllimi kryesor i administratës tatimore. Ai ka deklaruar se këto veprime janë kryer në harkun kohor të 60 minutave dhe se në ditët vijuese është mundësuar trajnimi nga ana e zyrës për deklarinim elektronik vetëm me sistemin e ri. Për rrjedhojë, ai ka konsideruar të pabazuar fillimin e ecurisë disiplinore.

4. Në datën 11.02.2015 në DPT është zhvilluar seanca dëgjimore me kërkuesin, si dhe janë administruar provat e paraqitura nga Drejtoria e Investigimit të Brendshëm dhe nga kërkuesi, kurse në datën 20.02.2015 është mbajtur procesverbali për shqyrtimin e ecurisë disiplinore ndaj tij. Me vendimin nr. 100, datë 20.02.2015 (*vendimi nr. 100/2015*), Komisioni i Disiplinës në DPT ka vendosur marrjen e masës disiplinore “Largimi nga shërbimi civil” për kërkuesin Riza Raza, me detyrë specialist në Sektorin e Shërbimit të Tatimpaguesit në DRT-

në, Dibër. Në datën 12.03.2015 kërkuesi i është drejtuar gjykatës me padi me objekt shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ, vendimit nr. 100/2015 të Komisionit të Disiplinës, kthimin në pozicionin e mëparshëm të punës dhe pagimin e pagës nga data e largimit deri në datën e rikthimit në detyrën e mëparshme. Si palë e paditur në gjykim janë thirrur DPT-ja dhe DRT-ja, Dibër.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2602 (80-2015-1235), datë 14.05.2015, ka vendosur pranimin e padisë, shfuqizimin e vendimit nr. 100/2015 të Komisionit të Disiplinës, detyrimin e DPT-së të kthejë paditësin Riza Raza (kërkuesin) në vendin e mëparshëm të punës dhe t'i paguajë pagën nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në kthimin në vendin e mëparshëm. Sipas saj, në zbatim të Rregullores nr. 3, datë 11.10.2010 "Për ofrimin e asistencës dhe shërbimeve për tatimpaguesit e regjistruar dhe individët nga funksioni i shërbimit ndaj tatimpaguesve në Drejtoritë Rajonale Tatimore" (*rregullorja nr. 3/2010*), të miratuar nga drejtori i DPT-së, veprimet e kërkuesit për dhënien e asistencës për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratave tatimore, si dhe për pagesën e tatimeve nga tatimpaguesit janë kryer në përmbushje të detyrave funksionale, sipas neneve 28 dhe 30 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 9920/2008*). Sipas asaj gjykate nuk u provua se paditësi e ka kryer këtë veprim me qëllim përfitimi apo që të jetë në kushtet e konfliktit të interesit, sipas nenit 26/1 të ligjit nr. 9920/2008 dhe Komisioni i Disiplinës nuk ka arritur të identifikojë qartë shkeljen shumë të rëndë të kryer nga paditësi, nuk ka arritur ta faktojë dhe provojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm ekzistencën e shkeljes dhe pasojën shumë të rëndë që ka sjellë, duke mos mbajtur parasysh nenin 60 të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar (*ligji nr. 152/2013*), konkretisht parimet për përshkallëzimin dhe individualizimin e masës disiplinore, pra parimin e proporcionalitetit, pasi është aplikuar masa më e rëndë disiplinore në kushtet kur nuk provohet kryerja e shkeljeve disiplinore ose ardhja e pasojave shumë të rënda nga këto shkelje. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur, DPT-ja.

6. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 86-2016-735 (3469), datë 26.10.2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj. Sipas gjykatës së apelit, gjykata e shkallës së parë ka gabuar në vlerësimin e saj në lidhje me zbatimin e ligjit material në rastin konkret, pasi kërkuesi ka vepruar në kundërshtim me ligjin, duke shfrytëzuar orarin zyrtar të punës dhe vendin e tij të punës në DRT-në, Dibër për deklaratimet *online* për 33 subjekte tatimpaguese dhe 11 subjekte tatimpagues të biznesit të vogël për formularin E-Sig 27. Sipas gjykatës së apelit, pavarësisht se neni 30 i ligjit nr. 9920/2008 parashikon se çdo tatimpagues

ka të drejtë të marrë informacion dhe të asistohet pa shpërblim nga administrata tatimore, paditësi (kërkuesi) e ka tejkalluar këtë përbushje të detyrimeve të administratës tatimore ndaj tatimpaguesit, pasi në vend që të sqaronte tatimpaguesit në lidhje me ndryshimet e kryera në sistemin informatik tatimor për deklaratimet *online* dhe t'i orientonte në lidhje me mënyrën e kryerjes së procesit, e ka kryer personalisht këtë proces. Sipas asaj gjykate, rregullorja nr. 3/2010 nuk ka të bëjë me kryerjen e deklaratimeve të tatimpaguesve nga ana e specialistëve të administratës tatimore, siç është vepruar në rastin konkret. Sipas asaj gjykate, Komisioni i Disiplinës ka identifikuar shkeljen e kryer dhe ka marrë një masë disiplinore në përputhje me shkeljen, si dhe me parimin e përshkallëzimit dhe individualizimit, pasi rezultoi se shkelja është shumë të rëndë, pasi është cenuar shumë rëndë parimi i funksionimit të punonjësit të administratës tatimore në marrëdhënie me tatimpaguesit dhe masa është në përputhje me parimin e përshkallëzimit, pasi ndaj paditësit është marrë një masë tjetër disiplinore për mospërbushje të detyrave (“Vërejtje me shkrim”) me vendimin nr. 686, datë 25.02.2014 të drejtorit të përgjithshëm të DPT-së. Kundër vendimit ka paraqitur rekurs kërkuesi Riza Raza.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-5218, datë 19.12.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (*ligji nr. 49/2012*). Sipas Gjykatës së Lartë kërkuesi nuk ka arritur të japë ndonjë argument për shkeljen e ligjit material e procedural apo shkeljet e rënda procedurale me pasojë pavlefshmërinë e vendimit e procedurës së gjykimit dhe se gjykata e apelit nuk rezultoi të ketë zhvilluar një proces të parregullt ligjor, të mos ketë garantuar zhvillimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes apo të mos ketë sqaruar rrethanat e faktet që lidhen me mosmarrëveshjen objekt gjykimi. Sipas asaj gjykate, Gjykata Administrative e Apelit, duke ndryshuar vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë, nuk del, sipas rekursit, që të ketë keqinterpretuar dispozitat e ligjit material nr. 9920/2008 dhe nr. 153/2013 në lidhje me konfliktin e interesit në të cilin gjendej paditësi (kërkuesi) në cilësinë e punonjësit në administratën tatimore në Dibër, me dhënien e konsulencës kontabël apo financiare ndaj tatimpaguesve.

8. Në datën 18.04.2024 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuesit

9. *Kërkuesi*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se në procesin gjyqësor të kundërshtuar i është cenuar:

9.1. *E drejta për proces të rregullt*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

9.1.1. *Së drejtës për t`u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi në trupin gjykues që ka gjykuar çështjen në gjykatën e apelit ka marrë pjesë gjyqtari K.S., që ka qenë edhe relator i çështjes, bashkëshortja e të cilit, shtetasja M.K., ka qenë drejtoreshë e Komisionit të Apelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Për rrjedhojë, ky gjyqtar ka qenë në kushtet e heqjes dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, pasi ka qenë në konflikt interesi, për sa kohë që palë e paditur në proces ka qenë administrata tatimore ku punonte bashkëshortja e tij. Në këtë pikëpamje ka qenë edhe vlerësimi i Komisionit të Posaçëm të Apelit për këtë gjyqtar, në rastet kur ka marrë pjesë në çështje me palë administratën tatimore. Për rrjedhojë, vendimi i gjykatës së apelit është absolutisht i pavlefshëm. Në kushtet kur kërkuesit nuk i është njoftuar nga gjykata e apelit data dhe ora e gjykimit, si dhe përbërja e trupit gjykues, atij i është mohuar e drejta për të paraqitur kërkesa të ligjshme, përfshirë ato në drejtim të trupit gjykues.

9.1.2. *Së drejtës për t`u njoftuar dhe për të marrë pjesë në gjykim*, për shkak të ndryshimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimit të padisë mbi të njëjtat prova në dhomën e këshillimit.

9.1.3. *Gjykatat kanë keqinterpretuar, në mënyrë të njëanshme, ligjin nr. 152/2013* në drejtim të kuptimit të shkeljeve disiplinore të parashikuara në nenin 57 të tij dhe përgjegjësisë disiplinore në varësi të shkeljes konkrete. Në rastin konkret, referuar provave të administruara në gjykim, nuk provohet që kërkuesi të ketë kryer shkeljet disiplinore për të cilat është proceduar, ndërkohë që as pala e paditur, edhe pse kishte barrën e provës, nuk ka vërtetuar kryerjen e tyre, pra se kërkuesi nuk ka përmbushur detyrat e tij. Për rrjedhojë, vendimi nr. 100/2015 i Komisionit të Disiplinës është i paligjshëm në kuptim të nenit 109/d të Kodit të Procedurës Administrative (KPA).

9.2. *Parimi i mosdiskriminimit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi kërkuesi është diskriminuar për shkaqe politike.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesës

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

11. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, në cilësinë e palës paditëse, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues për kundërshtimin e vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Kërkuesi, në drejtim të parimit të paanshmërisë, ka pretenduar në kërkesë se për shkak se nuk i është njoftuar nga gjykata e apelit data dhe ora e gjyqimit, si dhe përbërja e trupit gjykues, atij i është mohuar e drejta për të paraqitur kërkesa të ligjshme, përfshirë ato në drejtim të trupit gjykues. Po kështu, ai ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për t’u njoftuar dhe për të marrë pjesë në gjykim, për shkak të ndryshimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimit të padisë mbi të njëjtat prova në dhomën e këshillimit. Kolegji, referuar akteve bashkëlidhur kërkesës, vëren se në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë pretendimin për zhvillimin e procesit gjyqësor nga gjykata e apelit në dhomën e këshillimit kërkuesi e ka lidhur me të drejtën për t’u përfaqësuar dhe mbrojtur në gjykim, sepse ai ka qenë në mungesë në seancën gjyqësore dhe nuk është dëgjuar për shkak të zhvillimit të saj në dhomën e këshillimit, ndërkohë që pretendimet në drejtim të njoftimit për datën dhe orën e seancës gjyqësore nga gjykata e apelit rezultojnë të jenë ngritur për herë të parë në ankimin

kushtetues, duke mos u shteruar mjetet e ankimit në këtë drejtim. Po kështu, Kolegji vëren se edhe pretendimi për diskriminimin e tij për shkaqe politike nga ana e punëdhënësit nuk rezulton të jetë parashtruar nga kërkuesi gjatë procesit gjyqësor të kundërshtuar, por është artikuluar për herë të parë në ankimin kushtetues individual. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se në lidhje me pretendimet për mungesën e njoftimit nga gjykata e apelit për datën dhe orën e gjykimit dhe për diskriminimin e tij për shkaqe politike kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, ndaj këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim.

13. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuesit, Kolegji vëren se ato janë ngritur paraprakisht nga kërkuesi në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë konsiderohet se në lidhje me to ai ka shteruar në formë e substancë mjetet e ankimit.

14. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 19.12.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 18.04.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

15. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, i cili verifikohet në drejtim të pretendimeve të parashtruara në kërkesë, rezulton se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për t`u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, për shkak se në trupin gjykues që ka shqyrtuar çështjen në Gjykatën Administrative të Apelit ka marrë pjesë gjyqtari K.S., bashkëshortja e të cilit ka qenë e punësuar pranë palës së paditur, në atë kohë në detyrën e drejtoreshës së Komisionit të Apelit në DPT. Sipas kërkuesit, ky gjyqtar duhej të jepte dorëheqjen nga gjykimi i çështjes, për shkak se ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit. Po sipas kërkuesit, duke qenë se ai nuk është njoftuar nga gjykata e apelit për datën dhe orën e gjykimit, si dhe për përbërjen e trupit gjykues, atij i është mohuar e drejta për të paraqitur kërkesa të ligjshme, përfshirë ato në drejtim të trupit gjykues.

16. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv*, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimi nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim (*shih vendimet nr. 24, datë 11.10.2022; nr. 15, datë 11.03.2021; nr. 6, datë 29.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Testi subjektiv kërkon të provuarit e faktit se bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e gjykatës,

kurse testi objektiv kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë (*shih vendimin nr. 49, datë 10.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Kolegji vëren se kërkuesi e ka mbështetur këtë pretendim në qëndrimin e mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendimin nr. 15, datë 18.06.2021, me të cilin është vendosur shkarkimi nga detyra i gjyqtarit K.S. Referuar atij vendimi, pavarësisht qëndrimit të mbajtur në drejtim të nivelit të duhur të dilijencës që nevojitet për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit, për rastet e verifikuara është mbajtur qëndrimi se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit (gjyqtari K.S.) nuk kishte pasur ndonjë rol vendimmarrës dhe as nuk kishte nënshkruar ndonjë akt përfaqësimi për llogari të administratës tatimore në ato çështje në të cilat institucioni ishte palë dhe se nuk kishte rezultuar ndonjë e dhënë që ta vinte atë gjyqtar, si anëtar i trupit gjykues që kishte gjykuar çështjet, në kushtet e konfliktit në dukje të interesit, për shkak të përfshirjes së bashkëshortes në procedurat tatimore të kontestuara gjyqësisht (*shih paragrafin 26.21 të vendimit nr. 15, datë 18.06.2021 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit*).

18. Kolegji, në lidhje me këtë pretendim të kërkuetit, vlerëson se ai, edhe pse ka detyrimin dhe barrën e provës në drejtim të provueshmërisë së pretendimeve, nuk ka sjellë prova ose fakte bindëse që të provojnë se bashkëshortja e gjyqtarit K.S. ka qenë pjesë e procedurës administrative të zhvilluar ndaj tij apo rolin e saj në atë procedim, çka do të përbënte shkak të justifikuar për heqjen dorë të atij gjyqtari nga gjykimi i çështjes. Vetëm fakti se ajo ka qenë e punësuar pranë administratës tatimore nuk është i mjaftueshëm në nivel kushtetues për të krijuar dyshim të justifikuar për mosrespektimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme. Kolegji vëren, gjithashtu, se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës Administrative të Apelit është marrë njëzëri nga të tre gjyqtarët e trupit gjykues, pra nuk rezulton që gjyqtari në fjalë të ketë pasur votë përcaktuese në rastin konkret. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuetit është haptazi i pabazuar.

19. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe për të marrë pjesë në seancën gjyqësore në gjykatën e apelit, Kolegji vëren se kërkuesi e ka lidhur me faktin se gjykimi në atë gjykatë është zhvilluar në dhomën e këshillimit, ku është vendosur ndryshimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimi i padisë. Referuar parashikimeve të dispozitave procedurale të ligjit nr. 49/2012, që rregullojnë procedurën e gjykimit në gjykatën e apelit, rezulton se shqyrtimi i ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, si rregull, bëhet

mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit dhe për njoftimin e palëve zbatohen rregullat procedurale në gjykimin civil në Gjykatën e Lartë (neni 49), ndërkohë që për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, ajo gjykatë vendos nëse çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012. Kurse sipas nenit 50 të po atij ligji, Gjykata Administrative e Apelit në dhomë këshillimi vendos: a) mospranimin e ankimit; b) lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë; c) ndryshimin e vendimit; ç) prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim; d) prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

20. Referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij shqyrtimi, Kolegji vëren se në datën 05.10.2016 gjyqtari i çështjes, bazuar në nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 ka vendosur shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit në datën 24.10.2016, si dhe njoftimin nga sekretaria gjyqësore të palëve ndërgjyqëse me shpallje. Në shpalljen për datën dhe orën e gjykimit, të administruar në dosjen gjyqësore, rezulton edhe shënimi se palët kanë të drejtë të dorëzojnë parashtrime me shkrim deri në pesë ditë përpara datës së shqyrtimit të çështjes. Referuar procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 24.10.2016, ajo nuk është zhvilluar për shkak të mosplotësimit të trupit gjykues dhe është shtyrë për në datën 26.10.2016, datë që rezulton të jetë njoftuar sërish nga sekretaria gjyqësore, sipas shpalljes të administruar në dosjen gjyqësore. Në seancën gjyqësore të datës 26.10.2016 Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë.

21. Referuar përmbajtjes së ankimit kushtetues individual kërkuesi nuk ka pretenduar dhe as nuk ka provuar mungesën e komunikimit të ankimit të palës së paditur, DPT-së, apo se ka qenë në pamundësi të paraqesë pretendimet dhe argumentet e tij me shkrim për të kundërshtuar pretendimet dhe shkaqet e parashtruara në ankimin e palës tjetër në gjykim. Kolegji vlerëson se e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt, nuk nënkupton vetëm atë për t'u dëgjuar personalisht para gjykatës, por ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra mbi komentet dhe shpjegimet e dhëna me shkrim nga palët ndërgjyqëse. Në këtë kuptim, vetëm shqyrtimi i çështjes së kërkuesit në dhomën e këshillimit nuk është i mjaftueshëm në aspektin kushtetues për të vënë në dyshim të drejtën për proces të rregullt, për sa kohë që Gjykata Administrative e Apelit ka vepruar në përputhje me rregullat procedurale që gjejnë zbatim gjatë atij gjykimi, si dhe me kompetencat e saj. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

22. Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se gjykatat kanë keqinterpretuar, në mënyrë të njëanshme, ligjin nr. 152/2013 në drejtim të kuptimit të shkeljeve disiplinore të parashikuara në nenin 57 të tij dhe të përgjegjësisë disiplinore në varësi të shkeljes

konkrete. Sipas kërkuessit, në rastin konkret, referuar provave të administruara në gjykim, nuk provohet që ai të ketë kryer shkeljet disiplinore për të cilat është proceduar, ndërkohë që as pala e paditur (punëdhënësi), edhe pse kishte barrën e provës, nuk ka vërtetuar kryerjen e tyre, pra se kërkuessi nuk ka përmbushur detyrat e tij. Për rrjedhojë, sipas kërkuessit, vendimi nr. 100/2015 i Komisionit të Disiplinës është i paligjshëm në kuptim të nenit 109/d të KPA-së.

23. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Roli i Gjykatës nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që ushtron Gjykata nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor dhe aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete. Interpretimi i ligjit është atribut i gjykatave të zakonshme, për sa kohë nuk cenon ndonjë element të procesit të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 7, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Kolegji, bazuar në këto standarde, vlerëson se pretendimet e mësipërme të kërkuessit kanë të bëjnë me çështje me natyrë thelbësisht ligjore për sa kohë lidhen me mënyrën se si gjykatat e zakonshme kanë zbatuar ligjin për nëpunësin civil në drejtim të fakteve dhe provave të administruara në procesin gjyqësor, e lidhur kjo me natyrën e veprimeve të kryera nga kërkuessi gjatë ushtrimit të detyrës së tij. Për sa kohë që këto pretendime kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit dhe shqyrtimit të provave, si dhe të interpretimit të ligjit të zbatueshëm ato bëjnë pjesë në juridiksionin e zakonshëm gjyqësor dhe nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues.

25. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a”, “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.